Edhe pse çështja që do të përshkruhet në këtë dokument mund të përshkruhet në terma të gjerë si një çështje që ka të bëjë me komunitetet jo-shumicë në Kosovë, ajo ka pasur një efekt veçanërisht të pakëndshëm te pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës. Kjo në veçanti për shkak të faktit se është shfaqur si rezultat i pranisë së organeve institucionale të Serbisë në Kosovë, si dhe faktit se shumica dërrmuese e serbëve që jetojnë në territorin e Kosovës gjithashtu janë në zotërim të shtetësisë së Republikës së Serbisë.

### *Komunitetet jo shumice dhe shtetësia e Kosovës*

Që nga viti 2011, numri i serbëve të Kosovës që kanë kërkuar dokumente personale të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës është gjithnjë në rritje. Një numër faktorësh kanë kontribuar në këtë fenomen, përfshi presionin e shtuar nga komuniteti ndërkombëtar, si dhe iniciativat nga ana e qeverisë së Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar për të zgjeruargjërësinë dhe thellësinë e integritit të tyre në strukturat ligjore dhe institucionale. Megjithëse serbët që jetojnë në jug të lumit Ibër kanë qenë ndoshta më të shpejtë për të aplikuar për dokumentet e Kosovës në të kaluarën, serbët në veri të Kosovës, në vitet e fundit kanë treguar gatishmëri në rritje për ta bërë këtë gjithashtu. Që nga gushti i vitit 2017, Ministria e Punëve të Brendshme ka lëshuar 33.986 letërnjoftime dhe 2.586 pasaporta për banorët e komunave veriore<sup>7</sup>. Pasi u tha kjo, një numër i madh dhe i panjohur i serbëve në Kosovë nuk i ka

<sup>6</sup> Ky numër bazohet në numrin në rritje të LNJ të Kosovës të lëshuara për banorët e veriut të Kosovës

<sup>7</sup> *Trend Analysis*, OJQ Aktiv, nëntor 2017

dokumentet e identitetit të Kosovës për shkak të vështirësive administrative ose për shkak të mosgatishmërisë nga ana e tyre për të marrë këto dokumente. Pavarësisht nëse janë regjistruar apo jo si shtetas të Kosovës, shumica dërrmuese e serbëve nga Kosova janë në zotërim dhe/ose kanë të drejtë të kenë dokumente identiteti të lëshuara nga Republika e Serbisë. Kjo do t'i vendoste këta individë në një situatë në të cilën, në parim, do të duhej të konsideroheshin me shtetësi të dyfishtë në posedim të dokumenteve që njihen ligjërisht nga qeveria e Kosovës.

Megjithatë, shumë nga këto dokumente që mund të jenë që nga letërnjoftimet deri te patentat e shoferëve dhe certifikatat e martesës janë lëshuar nga institucionet e Republikës së Serbisë serbëve që kanë adresë zyrtare në Kosovë. Këto institucione mund të përfshijnë institucione arsimore, shëndetësore, të mirëqenies dhe të tjera të ngjashme. Kjo ka rezultuar problematike për shumë aplikues, pasi që qeveria e Kosovës refuzon të njohë dokumentacionin e lëshuar nga organet e qeverisë së Serbisë që veprojnë në Kosovë dhe nuk e njohin legjitimitetin e pasaportave të Serbisë, organi lëshues i të cilave është Drejtorja Koordinuese për Kosovë dhe Metohi në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë. Origjina e këtyre politikave është e paqartë dhe stafi i AKTIV-it nuk ishte në gjendje të identifikonte një ligj apo urdhëresë administrative të Kosovës në cilën thuhet se punonjësit e shtetit nuk duhej t'i pranonin ato për aplikimet e shtetësisë. Megjithëse nuk janë kodifikuar në kornizën ligjore të Kosovës, ka indikacione se kjo rrjedh nga udhëzimet me gojë dhe deklaratat e Edita Tahirit në vitin 2016<sup>9,10</sup>. Ky argument si duket bazohet në pikëpamjen se Ministria e Punëve të Brendshme është i vetmi organ kompetent për lëshimin e dokumenteve të identitetit shtetasve të Kosovës<sup>11</sup>, prandaj me këtë çfarëdo dokumenti tjetër i lëshuar (banorëve të Kosovës në territorin e saj) nga cilado qeveri tjetër konsiderohet e pavlefshme. Çështja e pasaportave të Drejtorisë Koordinuese ishte rezultat i marrëveshjes për liberalizimin e vizave (do të shtjellohet më tej në seksionet e mëvonshme), të nënshkruar ndërmjet Republikës së Serbisë dhe Bashkimit Evropian në vitin 2009 dhe që rezultoi me krijimin e Drejtorisë Koordinuese, të cilës iu dha përgjegjësia e lëshimit të pasaportave për shtetasit serbë nga Kosova<sup>12</sup>. Përkundër kësaj, këto janë dokumente ligjore të udhëtimit të lëshuara nga një qeveri legjitime që shërben si dëshmi e shtetësisë së Republikës së Serbisë dhe prandaj duhet të pranohen si të tilla nga qeveritë tjera. Duke marrë parasysh këta faktorë, është po aq e paqartë se pse qeveria e Kosovës refuzon t'i lejojë serbët e Kosovës t'i përdorin ato kur kalojnë kufijtë. Një shkak potencial por i pakonfirmuar mund të jetë fakti që në vitin 2017 Bashkimi Evropian lëshoi një listë të “pasaportave imagjinare dhe kamufluere” të njohura, të papranueshme për udhëtimet ndërkombëtare që përfshin një nënkategori të quajtur *territore të cilat nuk janë të njohura ndërkombëtarisht* ku ishte përfshirë

---

<sup>8</sup> Ky numër përfshin 12,407 letërnjoftime për banorët e Mitrovicës së Veriut, 10,100 letërnjoftime për banorët e Leposaviqit dhe 5,507 dhe 5,972 banorët e Zubin Potokut dhe Zveçanit.

<sup>9</sup> <http://prishtinainsight.com/kosovo-bans-usage-serbian-parallel-id-cards/>

<sup>10</sup> <http://prishtinainsight.com/documented-yet-invalid-mag/>

<sup>11</sup> Intervistë me Shefin e Departamentit të Shtetësisë, Liridon Neziri, në Prishtinë më 20 mars 2018.

<sup>12</sup> <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2009:0366:FIN:EN:PDF>



edhe diçka që quhet “Qeveria e përkohshme e Serbisë në Kosovë”<sup>13</sup>. Cilido qoftë shkaku apo arsyeimi kryesor, kjo ka çuar në një numër incidentesh në kufirin ndërmjet Serbisë dhe Kosovës me ç’rast serbëve të Kosovës ose iu janë konfiskuar dokumentet ose iu është refuzuar kalimi kur autoritetet kanë parë se dokumentet e tyre janë lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë për banorët e komunave të Kosovës. Për shembull, që nga prilli i vitit 2018 policia kufitare në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, në përgjigje në kërkese për informatë nga OJQ AKTIV, ka deklaruar se pasaportat serbe të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese nuk janë dokumente të vlefshme udhëtimi. E gjithë kjo krijon një situatë të paqartë për ata serbë të Kosovës të cilët nuk janë zyrtarisht të regjistruar si shtetas të Kosovës, sepse statusi i tyre i saktë është i padefinuar dhe i paqartë: A konsiderohen shtetas të Kosovës të gjithë ata serbë të cilët kanë lindur ose kanë banuar në territorin e Kosovës për shumicën e jetës së tyre, pavarësisht mungesës së dokumenteve? Për më tepër, a ekziston e drejta për të MOS fituar shtetësinë e Kosovës? Kjo është një çështje tjetër ligjore e papërshtatshme, e cila nuk adresohet drejtpërdrejt nga korniza ligjore e Kosovës. Një numër i ekspertëve ligjorë dhe zyrtarëve shtetërorë pohuan se ata individë (domethënë serbë) të cilët përmbushin kriteret për marrjen e shtetësisë, por që zgjodhën të mos e bëjnë, janë në "shkelje të drejtpërdrejtë të kornizës ligjore dhe Kushtetutës së Kosovës"<sup>14</sup>. Për më tej, çështja drejtpërdrejtë lidhet me kërcënime të perceptuara ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Kjo ndoshta do të sugjeronte që çështja e sovranitetit ka ndikuar negativisht në organet qeverisëse të Kosovës. Ky qëndrim e ndërlikon edhe më shumë situatën për serbët e Kosovës, veçanërisht ata që nuk kanë shtetësi të Kosovës; ata e gjejnë veten në pozitë të padëshirueshme dhe të papërshtatshme në të cilën statusi i tyre ligjor është i papërcaktuar deri në masën që ata përballen me mundësinë e kufizimit të konsiderueshëm të lirisë së tyre të lëvizjes dhe të pamundësisë për të ushtruar të drejtat e tyre qytetare dhe kushtetuese si shtetas të Kosovës.

Siç u tha më parë, është e paqartë se në çfarë baze ligjore qeveria e Kosovës refuzon të pranojë legjitimitetin e dokumenteve të caktuara të lëshuara nga institucioni shtetëror i Republikës së Serbisë, pasi nuk ka asgjë në kornizën ligjore të Kosovës që sugjeron se ato nuk mund të përdoren në procesin e fitimit të shtetësisë së Kosovës<sup>15</sup>. Ekzistojnë dëshmi shtesë që sugjerojnë se zyrtarët e Kosovës nuk do të pranojnë kurrfarë dokumenti të lëshuar nga institucionet shtetërore të Republikës së Serbisë pas vitit 1998<sup>16</sup> si dëshmi të banimit të përhershëm në Kosovë ose që do të vendosin kushte të rënda për aplikuesit me të cilat parandalohet aftësia e tyre për të dëshmuar

---

<sup>13</sup>[https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/borders-and-visas/document-security/docs/list\\_of\\_known\\_fantasy\\_and\\_camouflage\\_passports\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/borders-and-visas/document-security/docs/list_of_known_fantasy_and_camouflage_passports_en.pdf)

<sup>14</sup>Fokus grupi i mbajtur më 22 mars 2018 me ekspertë ligjorë nga OJQ-të e Kosovës dhe të institucioneve gjyqësore

<sup>15</sup>Bazuar në intervistat me Zyrën e Avokatit të Popullit të Kosovës, ekspertët ligjorë dhe me përfaqësuesit politikë të komunitetit serb në Kosovë

<sup>16</sup>Intervistat me përfaqësueset e Avokatit të Popullit të Kosovës, Aleksandra Dimitrijeviq dhe Milana Shqeqiq.

prezencën e tyre në Kosovë<sup>17</sup> deri në atë masë sa për të qenë pasur të drejtë për të fituar shtetësinë. Duke e forcuar këtë, dëshmitë anekdotike në bazë të fokus grupeve dhe intervistave me autoritetet relevante<sup>18</sup> sugjerojnë se një numër i madh i serbëve me banim në Kosovë nuk kanë qenë në gjendje të marrin shtetësinë e Kosovës për shkak të problemeve administrative dhe/ose procedurale të lidhura drejtpërdrejt me refuzimin e qeverisë së Kosovës për të njohur një numër të gjerë dokumentesh të lëshuara nga të ashtuquajturat institucione paralele të qeverisë së Serbisë në Kosovë. Duhet të theksohet se nuk kishte fushatë informuese shoqëruese apo përpjekje për të sqaruar paqartësitë ligjore/administrative në procesin e fitimit të shtetësisë. Në një rast, një aplikues i lindur në vitin 1998 (pas afatit të janarit) nuk ishte në gjendje të procedonte kërkesën mu për këtë arsye. Për më tepër, po i njëjti person ka lindur në Kosovë nga prindër të lindur në Kosovë, por prapë i është thënë se nuk ishte në gjendje të ofronte dëshmi të mjaftueshme për këtë në bazë të dokumenteve të paraqitura sepse ato ishin lëshuar nga institucionet "paralele".

Ligji i Kosovës për Shtetësi në mënyrë shumë eksplicite lejon shtetësinë e dyfishtë ose të shumëfishtë dhe thekson se posedimi i dokumenteve personale të lëshuara nga shtetet e huaja nuk mund të rezultojë me humbjen e shtetësisë së Kosovës<sup>19</sup>. Ngjashëm, dhe për dallim nga një numër i madh shtetesh, siç janë Shtetet e Bashkuara,<sup>20</sup> Kosova nuk ka kusht ligjor për shtetasit e vet që shtetasit të cilët hyjnë ose dalin nga Kosova të shfrytëzojnë vetëpasaportat e tyre të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës. Në teori, kjo duhet t'i lejojë serbët e Kosovës të mbajnë shtetësinë e Serbisë duke vazhduar të qëndrojnë ligjërisht në Kosovë dhe madje të përdorin dokumentet e tyre të lëshuara nga Republika e Serbisë për të hyrë në territorin e Kosovës.

Në një përpjekje për të lehtësuar problemet dhe vështirësitë ligjore dhe për të thjeshtësuar procesin e marrjes së shtetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 2017 ka nxjerrë disa udhëzime administrative<sup>21</sup> të dizajnuara për të qartësuar dhe/ose thjeshtuar procedurat administrative në lidhje me aplikimet për shtetësi. Udhëzimet përshkruajnë, mjaft qartë, cilat dokumente mund të pranohen si dëshmi për qëndrim të vazhdueshëm ose lindje në Kosovë. Midis këtyre dokumenteve të përcaktuara në udhëzime janë dhe "letërnjoftimi i një vendi të huaj" dhe "pasaporta e një vendi të huaj"<sup>22</sup>. Përkundër urdhrimit administrativ, një numër i madh të serbëve të Kosovës ballafaqohen me vështirësi të jashtëzakonshme në marrjen e dokumenteve të

---

<sup>17</sup>Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit të Kosovës treguan se kjo ishte për shkak të mungesës së qartësisë administrative: Zyrtarët komunal kërkojnë që aplikuesit të dorëzojnë dokumente/dëshmi të shumëfishta kur vetëm një është e nevojshme

<sup>18</sup>Fokus grupi mbajtur në Mitrovicën e Veriut në 13 mars 2018 me individë të cilit nuk ishin në gjendje për të marrë shtetësinë e Kosovës dhe intervista(t) me përfaqësueset e Avokatit të Popullit të Kosovës, Aleksandra Dimitrijeviq dhe Milana Shqekiq.

<sup>19</sup>Ligji 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, Neni 3.1 dhe 3.2

<sup>20</sup><https://travel.state.gov/content/travel/en/legal/travel-legal-considerations/Advice-about-Possible-Loss-of-US-Nationality-Dual-Nationality/Dual-Nationality.html>

<sup>21</sup>Udhëzimi Administrativ nr. 05/2017 për kriteret që përmbajnë dëshmi për Shtetësinë e Republikës Federale të Jugosllavisë dhe banim të përhershëm në territorin e Kosovës më 1 janar 1998.

<sup>22</sup>IBID, Dokumentet e Pranuar

identitetit përkundër udhëzimeve të reja që synojnë lehtësimin e qasjes në shtetësi. Problemi është më i theksuar në veri të Kosovës dhe në mesin e personave të zhvendosur brenda vendit<sup>23</sup>, edhe pse ka pasur raste edhe në komunat me shumicë serbe në jug të Ibrit. Për më tepër, serbët e Kosovës (veçanërisht në veri) të lindur gjatë ose në pjesën e dytë viteve 1990 shpesh nuk kanë ndonjë dëshmi të pranueshme për institucionet e Kosovës se ata kanë lindur në Kosovë. Kjo mund t'i atribuohet faktit se certifikatat e lindjes, diplomat e arsimit dhe dokumentacioni tjetër potencial relevant është lëshuar nga institucionet e Serbisë për serbët në Kosovë ose nga Drejtoria Koordinuese Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dhe me këtë është i papranueshëm për institucionet e Kosovës<sup>24</sup>. Kjo ka vështirësuar shumë qasjen në shtetësi për shumë banorë të Kosovës.

Zyra e Avokatit të Popullit të Kosovës ka trajtuar gjithsej njëzetepesë (25) raste që përfshijnë gjithsej gjashtëdhjetë e pesë (65) persona të lidhur me çështjet e shtetësisë në vitin 2017. Duhet theksuar se këto raste zyrtare aktualisht janë në pritje në gjykatë(a) dhe se ato nuk reflektojnë domosdoshmërisht shkallën e problemit. Këtyre personave të përfshirë u është refuzuar zyrtarisht shtetësia e Kosovës për shkak të faktit se ata nuk përmbushën një ose më shumë kriteret të përcaktuara në Ligjin për Shtetësinë e Kosovës<sup>25</sup>. Rastet e paraqitura në OJQ Aktiv kishin të bënin me personat të cilët ose kishin lindur në Kosovë ose kishin banuar në Kosovë për periudhë prej pesë (5) vjetësh që nga 1 janari 1998. Për më tepër, një numër aplikuesish u këshilluan nga autoritetet përkatëse për t'u regjistruar si të huaj dhe për të aplikuar për qëndrim të përkohshëm sipas Ligjit të Kosovës për të Huajt<sup>26</sup>. Ky është një zhvillim interesant, sidomos kur merret parasysh fakti se shumë prej këtyre individëve përndryshe kanë lindur në territorin e Kosovës dhe/ose kanë lindur nga prindër e Kosovës<sup>27</sup>. Zyra e Avokatit të Popullit të Kosovës në qëndrimin e vet deklaroi se shumë nga problemet e përjetuara nga pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë janë për shkak të mungesës së njohurive dhe trajnimit nga ana e punëtorëve komunal<sup>28</sup>, të cilët nuk janë të njohur me procedurat për dhënien e dokumenteve të shtetësisë. Për më tepër, qëllimi i deklaruar i Zyrës së Avokatit të Popullit të Kosovës është që të kërkojë trajnim të mëtejshëm për punëtorët shtetëror dhe komunal që trajtojnë kërkesat e shtetësisë për të shmangur çështjet e ardhshme që lidhen me aplikimet. Pasi u tha kjo, është raportuar gjerësisht se disa individë u përballën me reagime armiqësore dhe/ose keqtrajtim të drejtpërdrejtë nga të gjitha nivelet, punonjësit komunal dhe të ministrive<sup>29</sup>. Për më tepër, refuzimet dhe shpjegimet për refuzimin e aplikacioneve për shtetësi u pranuan në gjuhën shqipe, gjë që pengonte aftësinë e aplikuesve për të

---

<sup>23</sup>Sipas deklaratave të përfaqësuesve të Zyrës së Avokatit të Popullit të Kosovës në Prishtinë, Mitrovicë të Veriut dhe Graçanicë.

<sup>24</sup>Rasti i një individi nga komuna jugore e Lipjanit tregon se aplikuesi ka lindur në Kosovë në vitin 1958.

<sup>25</sup>Sipas refuzimeve zyrtare nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe të nënshkruara nga Drejtorët e Departamentit të Shtetësisë.

<sup>26</sup>Individëve që kërkojnë shtetësi u është thënë nga autoritetet (komunale ose ministri) të aplikojnë për leje qëndrimi të përkohshme sipas nenit 41 të Ligjit për të Huajt (Ligji 04 / L-219)

<sup>27</sup>(burimi mungon këtu)

<sup>28</sup>Intervistë me Suzana Gashi, Zyra e Avokatit të Popullit, 22 mars 2018.

<sup>29</sup>(burimi mungon këtu)

kuptuar arsyet për refuzim. Natyrisht, është e vështirë të konstatohet nëse këto refuzime mund t'i atribuohen pengimit të qëllimtë nga ana e autoriteteve përkatëse ose nëse ato thjesht mund të shikohen si aplikim i larmishëm dhe jo i njësuar i Ligjit për Shtetësinë që rrjedh nga fakti që disa punonjës shtetëror nuk kanë trajnim të mjaftueshëm për të trajtuar këto kërkesa. Sidoqoftë, është simptomatikë e një problemi më të gjerë dhe më sistematik që institucionet shtetërore deri tani nuk ishin në gjendje ose të nuk kishin dëshirë për të trajtuar këtë në mënyrë efektive.

Përfaqësuesit politik të komunitetit serb në Kosovë pretendojnë se këto probleme janë rezultat i qëndrimeve politike të punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, të cilët qëllimisht përpiqen të bllokojnë përpjekjet e serbëve për të marrë shtetësinë e Kosovës<sup>30</sup>. Për më tepër, po ashtu u theksua se këto veprime përbëjnë shkelje të Kushtetutës së Kosovës, si dhe të kornizës ligjore të dizajnuar për të ofruar mbrojtje për komunitetet jo-shumicë. Përfaqësuesit e Listës Serbe në Kuvendin e Kosovës aktualisht po punojnë në një sërë zgjidhjesh potenciale për këtë problem edhe pse nuk është arritur ndonjë marrëveshje konkrete për çështjet e shtetësisë në nivel qendror.

Çështja që ngrihet pa dyshim është kjo: nëse qeveria e Kosovës, me refuzimin e njohjes së vlefshmërisë së dokumenteve të identitetit dhe të tjera të lëshuara nga autoritetet e Serbisë për serbët e Kosovës, në mënyrë efektive ka bërë të pavlefshme shtetësinë e tyre serbe duke e shkelur drejtpërdrejtë Ligjin për shtetësinë? Për më tepër, kjo nxit spektrin e një situatë që është e afërt me pa shtetësinë për ata që nuk kanë dokumente të Kosovës, sepse shtetësia e tyre e Serbisë në praktikë është shfuqizuar nga qëndrimi i qeverisë së Kosovës në lidhje me vlefshmërinë e dokumenteve të lëshuara nga Republika e Serbisë për serbët e Kosovës përkundër faktit se shtetësia e dyfishtë dhe/ose e shumëfishtë është përndryshe e lejuar nga ligji i Kosovës. Që nga viti 2008 kishte mungesë të përgjithshme të informacioneve në dispozicion për banorët kur është fjala për çështjet e shtetësisë. Pjesëtarët e komuniteteve jo shumice shpesh nuk janë të vetëdijshëm për të drejtën e tyre për qasje në shtetësi, si dhe për mekanizmat (siç është Zyra e Avokatit të Popullit) që mund të adresojnë shkeljen e të drejtave. Këtu gjithashtu duhet të theksohet se kjo çështje u ngrit kryesisht pa paralajmërim dhe pa ndonjë përpjekje të madhe dhe të bashkërenduar nga ana e akterëve relevantë për të informuar komunitetet lokale. Kjo ka shpërthyer në një situatë që në disa aspekte ka dalë jashtë kontrollit në atë masë sa që organet qeverisëse, si dhe strukturat e dizajnuara për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe ato qytetare, gjejnë veten janë duke shënuar humbje kur është fjala për detyrën në dukje shumë të thjeshtë të qasjes në dokumentet përkatëse të nevojshme për të vërtetuar identitetin e dikujt.

### **Shembuj:**

- Një grua e lindur në një komunë në Serbi (atëherë pjesë e Republikës Federative të Jugosllavisë) ka banuar në Komunën e Lipjanit që nga viti 1970 dhe ka ofruar dokumente autoriteteve përkatëse si dëshmi. Përkundër kësaj, ajo mori një njoftim zyrtar për refuzim.

---

<sup>30</sup>Intervistë me Igor Simiq, deputet në Kuvendin e Kosovës, Lista Serbe më 20 mars 2018.

- Një burrë i lindur në vitet 1950 në komunën e Pejës dhe i cili ka jetuar aty deri në vitet 1990 kur shkoj në Beograd për shkak të konfliktit në Kosovë. Ai u refuzua, pavarësisht sigurimit të provave të letrave që tregonin se ai kishte lindur në Kosovë dhe kishte jetuar aty pjesën më të madhe të jetës së tij. Ai gjithashtu u këshillua nga autoritetet për të aplikuar për qëndrim si i huaj.

### III. Shtetësia e Kosovës: Perspektiva ligjore

#### *Analiza e mëposhtme pasqyron pikëpamjet e një eksperti të jashtëm ligjor dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e OJQ AKTIV*

Që nga një fazë e hershme, dialogu midis Kosovës dhe Serbisë u vlerësua nga partitë politike dhe shoqëria civile dhe u kritikua që nga fshehtësia deri te përjashtimi i akterëve të ndryshëm shoqëror<sup>31</sup>. Në Kosovë ky tension çoi në miratimin e "Rezolutës për Normalizimin e Marrëdhënieve Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë" dhe zotimet e paplotësuara për të ratifikuar marrëveshjet në parlament. Rezoluta adresoi shqetësimet kryesore që u theksuan: sovraniteti i Kosovës, integriteti territorial dhe rregullimi i brendshëm kushtetues nuk do të ndikoheshin nga ky proces, respektivisht rezultatet do të ishin në përputhje me to. Për më tepër, qeveria publikoi një platformë për dialog teknik ndërshtetëror me Serbinë, duke përcaktuar parimet, agjendën dhe objektivat<sup>32</sup>. Parimi kryesor, statusi i panegociueshëm, ishte rreth statusit të Kosovës. Kosova do të merrte pjesë në dialog si një entitet shtetëror, me status të barabartë me Serbinë, siç është e qartë edhe nga titulli i platformës.

Objektivat e dialogut kanë pësuar ndryshim i cili është pasqyruar në politikat ndërmjet vendeve. Vështirësia e fundit e cila është shfaqur, përsëri në lidhje me aspektin më themelor të marrëveshjes 7-vjeçare të lirisë së lëvizjes - respektivisht refuzimi reciprok për të njohur dokumentet e identifikimit. Një politikë e tillë është e rëndësishme për pjesëmarrjen e pakicës serbe në jetën publike në Kosovë dhe lëvizjen e tyre të lirë midis Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, ritmi i ngadalshëm i integritetit që ka ndikuar në pakicën serbe në Kosovë vetëm e ka përkeqësuar situatën. Dështimi, nga njëra anë e qeverisë së Kosovës dhe, nga ana tjetër, pakicës serbe, veçanërisht në komunat me shumicë serbe, për të arritur integritetin në shoqëri vërehet në fusha të ndryshme. Kjo, nga ana tjetër, e ka aktualizuar çështjen e shtetësisë për pakicën serbe në Kosovë.

Situata komplekse në të cilën janë gjetur personat me prejardhje serbe në Kosovë, për shkak të hezitimit të tyre për të kërkuar shtetësinë kosovare, pasqyron natyrën e këtyre problemeve. Duke pasur parasysh mungesën e integritetit në shoqëri dhe paqartësinë e politikës ndërmjet dy vendeve, pakica serbe ka ngurrar të përcaktojë pozicionin e saj ligjor në Kosovë - një numër i madh personash ende posedojnë vetëm dokumente të identifikimit të qeverisë së Serbisë, gjë që i vë ata në një pozitë të ndërlikuar në marrëdhëniet e tyre me autoritetet e Kosovës.

<sup>31</sup> Shih për shembull komentet e kryeredaktorit të Kohës Ditore: <http://prishtinainsight.com/four-years-later-report-discusses-kosovo-serbia-dialogue-deadlock/>

<sup>32</sup> Mund të gjendet në: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,253>



Nga njëra anë, Kushtetuta e Serbisë përcakton kohezionin e saj me Kosovën, pra nga këndvështrimi ligjor; qeveria e Serbisë i konsideron shtetasit e Kosovës si shtetas të Serbisë<sup>33</sup>. Në vitin 2009, BE-ja miratoi një regjim të ri pa viza për Serbinë, me të cilin i lejohet shtetasve të Serbisë udhëtimi i lirë brenda zonës Shengen. Edhe pse rekomandimet për liberalizimin e vizave erdhën si pako propozimesh edhe për Malin e Zi dhe Maqedoninë, Kosova nuk ishte përfshirë në atë listë dhe regjimi mbeti i njëjtë<sup>34</sup>. Për më tej, Komisioni Evropian mendoi se nuk mund të verifikonin integritetin dhe sigurinë e procedurave në lidhje me lëshimin e pasaportave të Serbisë për banorët e Kosovës. Si rezultat i kësaj enigme ligjore midis Serbisë dhe Kosovës, si dhe të shqetësimit të BE-së se kjo mund të çonte në abuzime, qeveria e Serbisë themeloi Drejtorinë Koordinuese që lëshonte pasaporta për këta persona<sup>35</sup>. Megjithatë, për të bërë këtë Serbisë iu desh të krijonte një lloj tjetër pasaporte për serbët që jetojnë në Kosovë - duke krijuar një sistem të dyfishtë të shtetësisë, bazuar në territorin e banimit: pasaportën zyrtare për personat që jetojnë në territorin e Serbisë, që janë subjekt i Ligjit të Serbisë për Shtetësinë; pasaportën e dytë, të lëshuar nga Drejtoria Koordinuese, që nuk është e përfshirë në marrëveshjen e liberalizimit të vizave Shengen<sup>36</sup>. Këta persona jetojnë në territorin e Kosovës, ndërsa autoritetet e Kosovës, në bazë të sovranitetit të tyre territorial, kërkojnë që ata të kenë një leje qëndrimi dhe, në përpjekje për të forcuar sovranitetin e saj, avokojnë që ata të kërkojnë shtetësinë e Kosovës.

Autoritetet kosovare mohojnë vlefshmërinë e pasaportës së lëshuar nga Drejtoria Koordinuese në Serbi<sup>37</sup>. Një mohim i tillë bazohet në konceptin e reciprocitetit nga e drejta ndërkombëtare dhe në rendin kushtetues të Kosovës sepse qeveria e Serbisë lëshon pasaportën në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e saj, me të cilat Kosova konsiderohet si pjesë të Serbisë, një qëndrim që nuk është në përputhje me atë të Kushtetutës së Kosovës në dispozitat e saj bazike. Neni i parë dhe i dytë i Kushtetutës përcaktojnë sovranitetin, pandashmërinë dhe integritetin territorial të Kosovës<sup>38</sup>. Në të njëjtën kohë, këta persona nuk mund të konsiderohen pa shtetësi, pasi ata, me posedimin e pasaportave të Drejtorisë Koordinuese, krijojnë shtetësinë e tyre me Republikën e Serbisë. Për më tepër, Kushtetuta e Kosovës parasheh edhe arsye në bazë të cilave liria e lëvizjes së të huajve<sup>39</sup>, që do të thotë jo-shtetasit, mund të kufizohet, gjë që mund të komplikojë më tej jetën e tyre në Kosovë, pasi atyre mund t'iu ndalohet hyrja në vend.

---

<sup>33</sup>[http://www.srbija.gov.rs/cinjenice\\_o\\_srbiji/ustav.php?change\\_lang=en](http://www.srbija.gov.rs/cinjenice_o_srbiji/ustav.php?change_lang=en)

<sup>34</sup>Marrëveshja ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Serbisë për lehtësimin e lëshimit të vizave mund të gjendet në: [https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/borders-and-visas/visa-policy\\_en](https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/borders-and-visas/visa-policy_en)

<sup>35</sup>[http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-09-1852\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-09-1852_en.htm)

<sup>36</sup>[http://www.mup.gov.rs/cms\\_lat/sadrzaj.nsf/biometrijska-dokumenta-KiM.h](http://www.mup.gov.rs/cms_lat/sadrzaj.nsf/biometrijska-dokumenta-KiM.h)

<sup>37</sup> Z. Dren Zeka, këshilltar i ish-ministres të dialogut, znj. Edita Tahiri, citohet në: <http://prishtinainsight.com/documented-yet-invalid-mag/>

<sup>38</sup>[www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf)

<sup>39</sup>Kushtetuta, Neni 35 për Lirinë e Lëvizjes, paragrafi 5

Nga ana tjetër, Kushtetuta e Kosovës është e dizajnuar për të siguruar mbrojtje të gjerë<sup>40</sup> të drejtave të njeriut. Përveç listimit të një numri të drejtave individuale dhe kolektive të njeriut, neni 21 i Kushtetutës integron instrumente të ndryshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në sistemin e brendshëm. Rrjedhimisht, ndër të tjera, adopton Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike<sup>41</sup>. Neni 14 i Kushtetutës për shtetësinë sqaron se fitimi dhe humbja e shtetësisë parashikohet me ligj. Për më shumë, neni 155<sup>42</sup> njeh të drejtën e shtetësisë për të gjithë banorët e ligjshëm të Kosovës në datën e miratimit dhe për shtetasit e ish-Republikës Federative të Jugosllavisë “pavarësisht nga vendbanimi i tyre i tanishëm dhe shtetësia që ata kanë, të gjithë qytetarëve të ish Republikës Federative të Jugosllavisë, të cilët kanë qenë banorë të përhershëm të Kosovës me datën 1 janar 1998, dhe pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë”<sup>43</sup>.

Ligji për shtetësinë (në tekstin e mëtejshëm: ligji) e Kosovës ishte një nga ligjet e para që duhej të miratohej pas shpalljes së pavarësisë<sup>44</sup>. Prima facie, ligji për shtetësinë e Kosovës është i ngurtë duke ofruar një rregullativë ligjore gjithëpërfshirëse. Aty përcaktohen procedurat për fitimin dhe humbjen e shtetësisë së Kosovës<sup>45</sup>. Me të parashihet shtetësi e shumëfishtë: nuk ka limit për numrin e shtetësive që mund të ketë personi, dispozitë ligjore që kryesisht reflekton komunitetin e diasporës dhe marrëdhëniet e pakicave në Kosovë<sup>46</sup>. Shtetësia e dyfishtë ose e shumëfishtë paraqet konsiderim të politikave dhe nuk lidhet me asnjë të drejtë themelore - shumë vende kanë rregulla ligjore që lejojnë vetëm një shtetësi<sup>47</sup>. Përveç bazave të rregullta krahasuese mbi të cilat një person fiton shtetësinë<sup>48</sup>, ligji gjithashtu përcakton dy kritere të tjera ligjore që rrjedhin nga neni 155 i Kushtetutës, të cilat pasqyrohen në nenet 31 dhe 32 të Ligjit. Neni 31 përcakton që personat e regjistruar në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut si banorë të përhershëm konsiderohen shtetas kosovar, edhe pse organi kompetent mund të kërkojë verifikim<sup>49</sup>. Për më tepër, sipas nenit 32 të ligjit, të gjithë personat që deri më 1 janar të vitit 1998 ishin banorë të përhershëm në Kosovë dhe ishin shtetas të Republikës Federative të Jugosllavisë, janë regjistruar si shtetas, ndërsa efekti juridik shtrihet edhe tek pasardhësit e tyre të drejtpërdrejtë<sup>50</sup>.

---

<sup>40</sup>Shiko për këtë: Commission Staff Working Document, 2008 Progress Report, Commission of the European Communities, (SEC) 2008, 2697

<sup>41</sup>Supra note.12

<sup>42</sup>Neni 155, me amandamentim është zhvendosur në kapitullin e parë, mund të gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3293>

<sup>43</sup>Supra note.12

<sup>44</sup>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 26/ 2 qershor 2008, Ligji 03/L-034, i shfuqizuar dhe i zëvendësuar me Ligjin Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës

<sup>45</sup>Ligji Nr. 04 / L-215 - Neni 1 Fushëveprimi

<sup>46</sup>Ibid. Neni 3 - Shtetësia e shumëfishtë

<sup>47</sup>Shih për këtë: Migration and Citizenship: Legal Status, Rights and Political Participation (2006), Rainer Bauböck

<sup>48</sup>Në përgjithësi, shtetësia mund të fitohet në këto mënyra: me prejardhje (jus sanguinis); natyralizim, që i nënshtrohet kritereve të ndryshme; nga lindja (jus soli). Ngjashëm, ligji në nenin 5 parashih këto modalitete: 1.1. Me lindje; 1.2. Me adoptim; 1.3. Me natyralizim; 1.4. Bazuar në traktatet ndërkombëtare; 1.5. bazuar në Nenin 31 dhe 32 të Ligjit.

<sup>49</sup>Ligji, Neni 31

<sup>50</sup>Ligji, Neni 32

Nenet 31 dhe 32 të Ligjit plotësohen me legjislacionin sekondar. Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 05/2017 rregullon kriteret që përbëjnë dëshmi për shtetësinë e Republikës Federative të Jugosllavisë dhe banimit të përhershëm në territorin e Kosovës më 1 janar 1998. Neni 3 i UA përcakton se personi duhet të ketë lindur në Kosovë para 1 janarit 1998 ose të ketë qëndruar në Kosovë për pesë vjet përpara kësaj date. Megjithatë, nëse nuk plotësojnë kushtet sepse ishin të detyruar të largohen nga Kosova para kësaj kohe, ata ende kualifikohen për shtetësi. Ky fakt vërtetohet nga një certifikatë e shtetësisë, martesës, pasaportës ose ndonjë dokumenti tjetër zyrtar të RFJ-së që i shërben këtij qëllimi. Sido që të jetë, sipas nenit 4, ata gjithashtu duhet të paraqesin një dokument identifikimi nga cilido vend tjetër ose agjenci e Kombeve të Bashkuara që ka shenjat e gishtave të tyre dhe një fotografi të personit. Udhëzimi ishte i nevojshëm për rregullimin e drejtë të kërkesave për shtetësi, veçanërisht për serbët dhe mundëson një numër të madh të dokumenteve të aplikueshme ose dëshmitarëve, për këtë qëllim.

Nga perspektiva e drejtës ndërkombëtare, fitimi i shtetësisë dhe procedurat që lidhen me të, janë kryesisht diskrecion i vendit dhe interpretimi i tillë është në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare, siç e ka theksuar GJN<sup>51</sup> në të kaluarën dhe nga shkenca<sup>52</sup>. Vetëm në rastet kur shteti pretendon mbrojtjen e një shtetasi të vet, drejta ndërkombëtare parashikon teste për të vendosur lidhjen midis vendit dhe qytetarit<sup>53</sup>. Të drejtat ndërkombëtare të njeriut, më saktësisht Deklarata Universale dhe Konventat e OKB-së për personat pa shtetësi, megjithatë përmend kufizime për rregullimin e kombësisë. Deklarata parashikon të drejtën e shtetësisë në nenin 15 dhe përcakton se askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga e drejta për shtetësi ose për të ndryshuar shtetësinë e tij. Gjithashtu, ekzistojnë detyrime ligjore që paraqiten në rastet e refugjatëve ose personave pa shtetësi, shtetet duhet të parandalojnë pa shtetësinë dhe të sigurojnë masa mbrojtëse ndaj personave të cilët përndryshe do të ishin pa shtetësi dhe duke u bazuar në lindjen në një territor ose nga prindërit që kanë atë shtetësi. Korniza ligjore e Kosovës rregullon çështjen e pa shtetësisë në pajtim me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe siç shpjegohet më sipër, një person pa shtetësi është dikush që "nuk konsiderohet shtetas nga ndonjë shtet sipas veprimit të ligjit të tij". Ky nuk është rasti me pakicën serbe që ka vetëm pasaportat e Drejtorisë Koordinuese, pasi ata konsiderohen shtetas të Serbisë.

Sidoqoftë, individët, qofshin të shtetësisë së Serbisë apo të tjera, nuk mund të ndalohen nga iniciimi i procesit të fitimit të shtetësisë në rastet kur kjo do të ishte në kundërshtim me dispozitat e ligjit. Ligji parasheh një numër rastesh në të cilat një personi nuk mund t'i jepet shtetësia, një prej të cilëve është refuzimi për të pranuar rendin kushtetues të Kosovës. Përveç kësaj, individit duhet të ndjekë kriteret dhe procedurat ligjore siç janë të përcaktuara në ligj. Legjislacioni sekondar në formën e Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga Ministria e Punëve të Brendshme më tej specifikon dhe rregullon këto kërkesa ligjore. Në rastet kur këto dispozita nuk ndiqen nga Departamenti për Shtetësi në Ministrinë e Punëve të Brendshme, personi mund të

---

<sup>51</sup>Nottebohm (Liechtenstein v. Guatemala), ICJ Reports 1955, fq. 4, 20

<sup>52</sup>Brownlie's Principles of Public International Law, 8<sup>th</sup> Edition, James Crawford, fq.529

<sup>53</sup>Supra note 25

ankohet në Komisionin për Ankesa për Shtetësi. Gjykatat gjithashtu mund ta rishikojnë atë procedurë.

Në përfundim, korniza ligjore që rregullon shtetësinë në Kosovë është projektuar për t'iu përshtatur situatës mjaft komplekse të pakicës serbe dhe pakicavetë tjera që janë pjesë e shoqërisë kosovare. Një kornizë e tillë plotësohet nga masat mbrojtëse të drejtave të njeriut që janë në dispozicion –të cilat megjithatëshpesh janë shumë të ngadalta ose ngecin në zbatim - ndërsa fitimi i shtetësisë mund të rrezikohet nga gabimi njerëzor, i cili është subjekt i shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor. Sidoqoftë, këto dispozita ligjore po dobësohen për shkak të ngërçit politik midis Kosovës dhe Serbisë - duke e vënë pakicën serbe në një pozitë të pasigurisë ligjore që do të mbetet kështu, përveç nëse qeveritë nuk ndërmarrin hapa për të vendosur në maje interesin e qytetarëve.

#### **IV. A trajtojnë në mënyrë specifike ligjet e Republikës së Serbisë çështjen e dokumenteve që lëshohen nga Drejtoria Koordinuese për Kosovë dhe Metohi në Ministrinë e Punëve të Brendshme?**

***Analiza e mëposhtme pasqyron pikëpamjet e një eksperti të jashtëm ligjor dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e OJQ AKTIV***

“Në Raportin e Komisionit Evropian për Serbinë, siguria e dokumenteve mbi të cilat bazohet dhënia e dokumenteve të udhëtimit ka marrë vlerësimin më të dobët. Kjo veçanërisht i referohej librave amzë nga territori i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë (KAMK). Është vërejtur se ambientet ku ruhen të dhënat janë të mbingarkuara dhe joadekuate. Rrjedhimisht, kjo çon në konkluzion se qasja në këto libra është e tillë që mbajtja dhe qasja e tyre nuk mund të sigurohen në mënyrën më të mirë. Procesi i lëshimit të certifikatave të lindjes u vlerësua si problematik kur është fjala për qasjen në forma të zbrazëta, mënyrat e plotësimit të të dhënave, gabimet gjuhësore në certifikata, etj. Gjithashtu u vu re se sistemi nuk mund të garantojë një shkallë të lartë të besueshmërisë së këtyre dokumenteve në të gjithë territorin dhe se situata dallon nga vendi në vend.

(European Commission Expert Report on fulfilment of the Roadmap legally-technical criteria related to the document security, faqe 16, shkurt 2009)"

Shih <http://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/Sloboda%20kretanja.pdf> )

Ligji për Dokumentet e Udhëtimit ka përcaktuar se kush gëzon të drejtën në dokumentin e udhëtimit të Republikës së Serbisë, cilat lloje të dokumenteve të udhëtimit ekzistojnë dhe në juridiksionin e kujt është lëshimi i dokumenteve të udhëtimit. Ligji parashikon një regjim të përgjithshëm ligjor të zbatueshëm për të gjithë shtetasit e Republikës së Serbisë.

Rregullorja për përcaktimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara për lëshimin e pasaportave për personat nga territori i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë, e nxjerrë më vonë dhe në bazë të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit, rregullon procesin e përcaktimit të përmbushjes së kërkesave të përcaktuara për lëshimin e pasaportave për shtetasit e Serbisë me vendbanim të përhershëm në territorin e Kosovës dhe Metohisë dhe për shtetasit të cilëve u lëshohen certifikatat e shtetësisë

nga organet e Republikës së Serbisë, përgjegjëse për territorin e Kosovës, e të cilët nuk kanë të drejtën e banimit të përhershëm në Serbi. Rregullorja u miratua rreth dy vjet pas miratimit të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit dhe pak para miratimit të Rregullores së Këshillit të BE-së në vitin 2009, që e ka vënë Serbinë në të ashtuquajturën Listë e Bardhë Shengen.

Ligji për Dokumentet e Udhëtimit parashikon një regjim të përgjithshëm ligjor të dokumenteve të njëjta të udhëtimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Serbisë. Devijimet nga regjimi i përgjithshëm i vendosur nga Rregullorja në fjalë - siguria dhe kontrole të tjera të nevojshme, ndër të tjera, për lajmërimin dhe çlajmërimin e vendbanimit të përhershëm dhe regjistrimin e adresës së shtëpisë që i referohet shtetasve të Serbisë me vendbanim të përhershëm në territorin e Kosovës dhe shtetasve të Serbisë, të cilëve u janë lëshuar certifikatat e shtetësisë nga autoritetet e Republikës së Serbisë, përgjegjëse për territorin e Kosovës dhe të cilët nuk kanë të lajmëruar qëndrimin e përhershëm në Serbi - nuk është i paraparë as me Ligjin për Dokumentet e Udhëtimit, e as me Ligjin për qëndrimin e përhershëm dhe përkohshëm të qytetarëve<sup>54</sup>.

Në praktikë, efekti i Rregullores është i tillë që për shembull, shtetasit e Serbisë nga Serbia lindore mund të lëvizin në Serbinë perëndimore pa kontrole, ndërsa të tjerët, si qytetarë të Serbisë me vendbanim të përhershëm në territorin e Kosovës nuk mund të lëvizin jashtë në drejtim të pjesëve të tjera të Serbisë pa kontrole.

Përveç kësaj, Rregullorja bën një ndryshim shtesë ndërmjet personave të zhvendosur brenda vendit nga territori i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë, në njërën anë, dhe shtetasve të Serbisë me vendbanim të përhershëm në territorin e Kosovës dhe shtetasve të Serbisë të cilëve u lëshohen certifikata e shtetësisë nga autoritetet e Republikës së Serbisë, përgjegjëse për territorin e Kosovës dhe të cilët nuk kanë të lajmëruar qëndrimin e përhershëm në Serbi, në anën tjetër - duke vendosur personat e zhvendosur brenda territorit nga Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë në një pozitë dhe regjim të pafavorshëm krahas atij që vlen për qytetarët nga pjesa qendrore e Serbisë.

Së fundi, derisa Ligji parashikon një regjim të përgjithshëm sipas të cilit të gjithë personat paraqesin kërkesë për lëshimin e pasaportës në drejtorinë e policisë ose në stacionin policor të Ministrisë së Punëve të Brendshme aty ku kanë vendbanimin e tyre të përhershëm ose të përkohshëm, Rregullorja udhëzon që shtetasit e Serbisë që banojnë në territorin e Kosovës dhe shtetasit e Serbisë me certifikatat e shtetësisë të lëshuara nga autoritetet e Republikës së Serbisë, përgjegjëse për territorin e Kosovës dhe të cilët nuk kanë të lajmëruar qëndrimin e përhershëm në Serbi - në Beograd, në Drejtorinë Koordinuese të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë.

---

<sup>54</sup>Të drejtat e qytetarëve rregullohen me ligj; shih më shumë në <http://www.ombudsman.rs/index.php/2011-12-25-10-17-15/2011-12-25-10-19-19/1007-qq1007>



Përveç devijimit nga regjimi i përgjithshëm ligjor për paraqitjen e dokumenteve të parapara me Ligjin për Dokumentet e Udhëtimit, gjithashtu është e diskutueshme nëse kjo dispozitë e Rregullores është në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë<sup>55</sup>. Procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Rregullores për procedurën për përcaktimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara për lëshimin e pasaportave për personat nga territori i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë, sipas të dhënave të disponueshme nuk është inicuar asnjëherë, megjithëse është e mundur që nga të lartpërmendurat të ekzistoj një arsye për këtë.

Praktikisht, përplasia midis kërkesave të Bashkimit Evropian dhe rregulloreve të Republikës së Serbisë që ndodhën në këtë rast është zgjidh thjesht duke mos u zgjidhur.

Kërkesat e vendosura për liberalizimin e vizave duhej të përmbusheshin pa asnjë dyshim. Mbetet pyetja nëse autoritetet e Republikës së Serbisë gjatë përmbushjes së tyre i kanë përmbushur në mënyrë që të mos shkelin të paktën parimet e qeverisjes së mirë ose parimin e barazisë së qytetarëve në të drejta dhe detyrime.

### ***Llojet e ndryshme të shtetësisë dhe llojet e ndryshme të pasaportave: Çfarë thuhet në rregulloret e Republikës së Serbisë në lidhje me këtë?***

Ligjet e Republikës së Serbisë përcaktojnë se kush ka shtetësinë e Republikës së Serbisë, si mund të fitohet shtetësia e Republikës së Serbisë dhe se si mund të ndërpritet kjo shtetësi.

Sipas Ligjit ekzistues për shtetësinë (LSH), shtetësia e Republikës së Serbisë fitohet me prejardhje ose me lindje në territorin e Republikës së Serbisë (sipas regjistrimit të faktit mbi shtetësinë në Librin e lindjeve), sipas pranimit (në bazë të vendimit të vlefshëm nga Ministria përgjegjëse për punët e brendshme pas përfundimit të procedurës së paraparë me ligj) dhe sipas traktateve ndërkombëtare (neni 6 LSH). Ligjvënësi devijon nga rregullat e përgjithshme për marrjen e shtetësisë së Republikës së Serbisë me pranim dhe parashikon regjim të favorshëm për *disa të huaj* ("Pavarësisht nga dispozitat e nenit 14, paragrafi 1, nën paragrafët 2 deri 4 të këtij ligji, një të huaj mund t'i jepet shtetësia e Republikës së Serbisë, nëse dhënia e shtetësisë së Republikës së Serbisë do të ishte me interes për Republikën e Serbisë. Qeveria e Republikës së Serbisë, me propozim të Ministrisë përgjegjëse, vendos për dhënien e shtetësisë së Republikës së Serbisë nga paragrafi 1 i këtij neni "(neni 19)).

Pjesëtarët e popullit serb që nuk kanë qëndrim të përhershëm në territorin e Republikës së Serbisë kanë të drejtë të marrin shtetësinë e Republikës së Serbisë pa u liruar nga shtetësia e huaj nëse kanë mbushur moshën 18 vjeç, nëse nuk i është hequr zotësia juridike dhe nëse paraqesin një deklaratë me shkrim ku e konsiderojnë Republikën e Serbisë shtet të tyre, ndërsa personat e lindur në një Republikë tjetër të ishRepublikës Socialiste Federative Jugosllavisë që kishin shtetësinë e asaj republike ose janë shtetas të një shteti tjetër të krijuar në territorin e ishRSFJ-së, të cilët janë me banim në territorin e Republikës së Serbisë si refugjatë, persona të dëbuar ose të

<sup>55</sup>Krijimi i shpenzimeve materiale shtesë; shih në <http://www.ombudsman.rs/index.php/dobra-uprava>

zhvendosur, si dhe pjesëtarët e kombeve të tjera ose bashkësive etnike nga territori i Republikës së Serbisë, gjithashtu mund të fitojnë shtetësinë e Republikës së Serbisë me kusht të kenë mbushur moshën 18 vjeç, nëse nuk i është hequr zotësia juridike që nuk janë të privuar nga aftësia ligjore dhe nëse paraqesin një deklaratë me shkrim ku e konsiderojnë Republikën e Serbisë shtet të tyre (neni 23). Me ndryshimet e marsit 2018, në Ligj u përfshi dispozita sipas së cilës shtetësia e Republikës së Serbisë mund të fitohet nga një shtetas i ish RSFJ-së ose një shtetas i një republike të ish RSFJ-së, që është shtetas i një shteti tjetër të formuar në territorin e RSFJ-së dhe i cili më 31 dhjetor 2016 dhe në ditën e paraqitjes së kërkesës ka qëndrim të përhershëm në Republikën e Serbisë (neni 3 [s2]).

Ligji vendor gjithashtu njeh mundësinë e lidhjes së një marrëveshjeje të dyfishtë të shtetësisë. Në kontekst rajonal, Bashkësia e Shteteve të Serbisë dhe Malit të Zi në vitin 2002 lidhi me Bosnje dhe Hercegovinën marrëveshjen për shtetësi të dyfishtë, që në kushte të caktuara i jep qytetarëve të njërës prej Shteteve Kontraktuese të drejtën për të fituar shtetësinë e Shtetit tjetër Kontraktues pa humbur shtetësinë e parë<sup>56</sup>. Kjo Marrëveshje është ende në fuqi në Republikën e Serbisë.

Çështja e dokumenteve të udhëtimit në Republikën e Serbisë rregullohet me Ligjin për Dokumentet e Udhëtimit - ky ligj rregullon dokumentet e udhëtimit të shtetasve të Republikës së Serbisë për udhëtime jashtë vendit, përcakton llojet e dokumenteve të udhëtimit dhe kushtet e lëshimit. Bartësi i dokumentit të udhëtimit, me përjashtim të dokumentit emergjent të udhëtimit, me të mund të dëshmojë identitetin e tij ose të saj dhe mund të dëshmojë se ai ose ajo është shtetas i Republikës së Serbisë. Dokumentet e udhëtimit në kuptim të këtij ligji janë pasaporta, pasaporta diplomatike, pasaporta zyrtare, dokumenti urgjent i udhëtimit, si dhe dokumente udhëtimi të lëshuara në bazë të traktatit ndërkombëtar. Me nënshkrimin e procedurës për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit, Ligji parasheh që "përveç aplikacionit për dokument udhëtimi, aplikuesi duhet të paraqesë letërnjoftimin e tij ose të saj ose një dokumenti tjetër publik që vërteton identitetin dhe shtetësinë, certifikatën e shtetësisë, si dhe dokumente të tjera që vërtetojnë të dhënat e dhëna në formularin e aplikimit"(Neni 30 i Ligjit për dokumentet e udhëtimit).

Për pasaportat, vetë Ligji për Dokumentet e Udhëtimit përcakton regjimin e përgjithshëm dhe nuk përmend shmangiet - sipas Ligjit, të gjitha pasaportat e lëshuara në përputhje me dispozitat e Ligjit janë të të njëjtit lloj dhe janë në të njëjtin regjim të drejtave dhe detyrimeve. Kur është fjala për pjesën e përmbajtjes së Rregullores së lartpërmendur që lidhet me lëshuesin e dokumenteve, Drejtoria Koordinuese e Ministrisë së Punëve të Brendshme është pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë dhe pasaporta ku organi lëshues është Drejtoria Koordinuese janë tërësisht në përputhje me ligjet e Republikës së Serbisë. Prandaj, në sistemin e brendshëm juridik, të gjitha pasaportat e lëshuara nga Republika e Serbisë janë në të njëjtin sistem juridik, të gjithë mbajtësit e tyre gëzojnë të njëjtën të drejtë për liri të lëvizjes siç interpretohet me dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe cilësia e tyre teknike është e barabartë (Dokumenti biometrik). "Regjimi i pasaportave të ndryshme" ndodh vetëm në situatë kur mbajtësi i pasaportës së lëshuar nga

---

<sup>56</sup>Shih <http://www.pf.uns.ac.rs/images/maja/16.pdf>

Drejtoria Koordinuese e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë vendos të largohet nga territori i Serbisë dhe udhëton drejt, të themi, njërit nga vendet e BE-së. Shumica e vendeve anëtare të BE-së në përputhje me Rregulloren e Këshillit të BE-së nga viti 2009 dhe/ose në përputhje me politikat e tyre të brendshme këmbëngulin në detektimine këtyre pasaportave të shënuara në këtë mënyrë nga Republika e Serbisë. Prandaj, shumica e vendeve të BE-së, dhe jo Serbia, ndryshe trajtojnë një grup të mbajtësve të pasaportës së Republikës së Serbisë nga grupi tjetër të mbajtësve të pasaportës së Republikës së Serbisë. Republika e Serbisë vetë e bëri të mundur trajtimin e tillë të mbajtësve të pasaportave të saj.

***Cilët hapa, nëse ka, kanë marrë autoritetet e Republikës së Serbisë për të zgjidhur problemet e serbëve të Kosovës të cilët janë bartës të dokumenteve personale të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese, e të cilët tregojnë komunitat e Serbisë në Kosovë si vendbanim të tyre të përhershëm?***

Në maj të vitit 2017, pasi u kuptua se Policia e Kosovës ishte duke parandaluar shtetasit e Kosovës të cilët janë mbajtës të pasaportave të Republikës së Serbisë të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë të largohen ose të kthehen në territorin e Kosovës me këto dokumente, autoritetet në Beograd iu përgjigjën kësaj praktike. Sipas të dhënave në dispozicion, u njoftuan përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, kryesisht OKB-ja dhe përfaqësuesit e BE-së.

Në gusht të vitit 2017, Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Serbisë në fjalimin e tij në takimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së kushtuar raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për punën e UNMIK-ut - në periudhën prej 16 prillit deri më 15 korrik 2017<sup>57</sup>, theksoi se në Raport vërehet "vazhdimi i akteve të njëanshme të Prishtinës është direktiva e fundit që ndalon përdorimin e pasaportave serbe të lëshuara nga Drejtoria e Koordinimit e Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë për të hyrë dhe dalë nga Kosova". Raporti në fjalë i UNMIK-ut paraqet faktet e një praktike të re në punën e Policisë së Kosovës, por nuk specifikon asnjë cilësim për vazhdimin e akteve të njëanshme<sup>58</sup>.

---

<sup>57</sup>Shih <http://www.mfa.gov.rs/sr/index.php/pres-servis/saopstenja/18492--16-15-2017-?lang=lat>

<sup>58</sup>"Më 2 maj Policia e Kosovës filloi zbatimin e një direktivë të Kosovës me të cilën pasaportat e Serbisë, të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, e cila është përgjegjëse për lëshimin e pasaportave për serbët që jetojnë në Kosovë, nuk janë më të vlefshme për udhëtim në dhe nga Kosova. Gjatë periudhës raportuese, udhëtarët që përdorin këto pasaporta u penguan të hyjnë ose të largohen nga Kosova. Ministri për Dialog i Kosovës, më 2 maj deklaroi se Drejtoria Koordinuese është një strukturë e paligjshme, prandaj edhe nuk njihen pasaportat e saj. Në kundërshtim, autoritetet serbe kanë kundërshtuar që, si një institucion qendror i vendosur në Beograd, Drejtoria Koordinuese nuk mund të konsiderohet si "institucion paralel" i Serbisë që vepron në Kosovë. Në kohën e raportimit, kufizimi i udhëtimit mbeti në fuqi. "Shih [https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/sg\\_report\\_on\\_unmik\\_0.pdf](https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/sg_report_on_unmik_0.pdf)

Në Raportin e Zyrës së Qeverisë së Republikës së Serbisë për Kosovë dhe Metohinë lidhje me përparimin në dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës në tetor 2017, thuhet se autoritetet në Prishtinë me "zbatimin e masave të njëanshme seriozisht kanë rrezikuar zbatimin e Marrëveshjes mbi lirinë e lëvizjes" lidhur me situatën në fjalë. Në Raport theksohet se autoritetet në Prishtinë nga prilli 2017 kanë ndaluar "përdorimin e letërnjoftimeve të lëshuara nga drejtoritë e zhvendosura të policisë nga Kosova dhe Metohia si dhe gjatë kalimit të kufirit me Maqedoni dhe Mali të Zi për personat që mbajnë pasaporta të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë" dhe se këto masa janë ende në fuqi. Sipas Raportit, ndërmjetësuesit nga Bashkimi Evropian janë informuar për shkeljen e Marrëveshjes për lirinë e lëvizjes<sup>59</sup>.

Gjithashtu, në dhjetor të vitit 2017, deputeti nga Lista Serbe në Kuvendin e Kosovës shpalli se "pritet që kjo çështje shumë e rëndësishme e përdorimit të pasaportave të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë të zgjidhet në vitin 2018 dhe se njoftimi verbal ... nga maji e bëri të pamundur që mbajtësit e këtyre pasaportave t'i përdorin ato .... dhe se kjo përbën një problem të tmerrshëm. Ne kishim një problem për të anuluar ... atë vendim .... sepse nuk ekziston. Drejtori i Policisë Kufitare bazuar në ... njoftimin verbal dha urdhër me gojë që e bënë të pamundur përdorimin e pasaportave të Drejtorisë Koordinuese." <sup>60</sup>

Megjithatë, sipas të dhënave në dispozicion, deri në momentin e përfundimit të punës në këtë tekst, nuk kishte ndryshim në qëndrimin e Kosovës ndaj mbajtësve të dokumenteve të udhëtimit të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese për Kosovë e Metohi.

"Mbrojtësi i qytetarëve të Republikës së Serbisë (ombudsmani) ende nuk është në gjendje të ushtrojë juridiksionin e vet në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe ligj. Sipas informatave në dispozicion dhe bazuar në pretendimet në ankesa, qytetarët në Kosovë dhe Metohi, veçanërisht ata me kombësi joshqiptare që jetojnë në enklava ende ballafaqohen me shkelje të rënda të të drejtave dhe lirive të njeriut. "(Raporti i Mbrojtësit të Qytetarëve për vitin 2017, fq.10) <sup>61</sup>

Duke folur në mënyrë institucionale, Mbrojtësi i qytetarëve të Republikës së Serbisë (ombudsmani) është një nga shtyllat më të rëndësishme për qytetarët të cilët janë dëmtuar në ushtrimin e të drejtave të tyre kur organet administrative nuk kanë aplikuar saktë ose nuk kanë aplikuar fare rregulloret. Edhe pse Mbrojtësi i qytetarëve të Republikës së Serbisë ekziston në sistemin ligjor që nga viti 2005, nuk dihet nëse autoritetet në Beograd që nga ajo kohë kanë bërë ndonjë përpjekje politike sistematike në, për shembull, ndarjen e mjeteve për të rritur kapacitetin dhe për të intensifikuar bashkëpunimin ndërmjet Mbrojtësit të qytetarëve të Republikës së Serbisë dhe

<sup>59</sup>Raporti për përparimin në dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës (për periudhën 30 prill deri më 31 tetor 2017), tetor 2017, <http://www.kim.gov.rs/pregovaracki-proces.php> #

<sup>60</sup><http://radiomitrovicasever.com/2017/12/21/igor-simic-kosovske-vozacke-mogu-da-dobiju-svi-oni-kojima-su-srpske-vozacke-dozvole-izdate-do-14-septembra-2016/>

<sup>61</sup><http://www.ombudsman.rs/attachments/article/5671/Godisnji%20izvestaj%20za%202017.%20godinu%201.pdf>

institucioneve të të drejtave të njeriut në Kosovë/Avokatit të Popullit në Kosovë në rastet kur autoritetet administrative i pengojnë ata që të ushtrojnë të drejtat e tyre. Një arsye më shumë për këtë do të ishte fakti se që nga themelimi i tij, qytetarët e Kosovës vazhdimisht dërgojnë ankesa tek Mbrojtësi i qytetarëve të Republikës së Serbisë, gjë që gjithashtu është përmendur në raportin më të fundit të Mbrojtësit.

Politikanët dhe përfaqësuesit e autoriteteve të ndryshme në Beograd që nga viti 2009 janë duke bërë thirrje publike dhe apele në BE për të amandamentuar Rregulloren e Këshillit të BE-së për vitin 2009 dhe për të ndryshuar me këtë trajtimin e mbajtësve të pasaportave të Drejtorisë Koordinuese të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë. Megjithatë, nga kjo distancë është e qartë se ato ishin vetëm deklarata jo-serioze, populliste, çorientuese. Megjithatë, në 10 vitet e fundit, asnjë qeveri e vetme nuk ka paraqitur asnjë propozim serioz, politikë ose strategji që ka për qëllim ndryshimin e Rregullores përkatëse, ndërsa kur është fjala për qasjen ndaj BE-së në këtë drejtim, as përfaqësuesve të BE-së as të shtesave të Republikës së Serbisë.

### **Cilat mekanizma ligjorë apo mekanizma të tjerë ekzistojnë për të ofruar ndihmë për serbët nga Kosova në aspekt të problemeve me shtetësinë?**

Në parim, për një person që të ushtrojë të drejtën në një dokument personal ose të udhëtimit para një autoriteti publik, është e nevojshme që një person të dëshmojë se ai është i regjistruar në regjistrin e lindjes ose në ndonjë regjistër tjetër të përshtatshëm, duke paraqitur vendimin ose certifikatën e regjistrit përkatës. Supozimi është se të dhënat zyrtare të statusit personal të qytetarëve janë të rregullta, të besueshme, të mirëmbajtura dhe të mbajtura në mënyrë të ligjshme.

Megjithatë, rezulton se ky supozim - në periudha pas konfliktit dhe në zonat pas konfliktit në veçanti - shumë shpesh nuk vlen në praktikë. Të dhënat e humbura, të dëmtuara në masë të madhe ose të shkatërruara të gjendjes personale të qytetarëve çojnë në një situatë në të cilën qytetarët vuajnë - barrën e provimit të shtetësisë dhe shpenzimin e resurseve (kohë, mjete) për procesin e rivendosjes së të dhënave në regjistra.

Në periudhën që nga përfundimi i konfliktit dhe më pas, një ndryshim i rëndësishëm në procesin politik i cili duhet të kishte rezultuar me përmirësimin e statusit të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë ishte përmes arritjes së një marrëveshje teknike në kuadër të procesit të negocimit ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës për librat amzë<sup>62</sup>. Sidoqoftë, shumë informacione nuk janë në dispozicion në publik për procesin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe të dhënat në dispozicion nga autoritetet në Beograd tregojnë se procesi rezulton të jetë me vështirësi<sup>63</sup>.

<sup>62</sup>Shih <http://www.kim.gov.rs/lat/p08.php>; Shih Rregulloren e Qeverisë së Serbisë për mënyrën e veçantë të përpunimit të të dhënave të librat për territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë

<sup>63</sup>Nga Raporti i Zyrës për Kosovë dhe Metohi të Qeverisë së Republikës së Serbisë për përparimin e dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës mund të mësohet se "ende ekzistojnë probleme në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për Librat ... Prishtina ende



Pengesa kryesore me të cilën përballen qytetarët është pikërisht marrja e një ekstrakti nga të dhënat të cilat janë zhvendosur ose nuk dihet se ku janë ose janë shkatërruar. Ekstraktet nga këto regjistra janë çelësi për gëzimin e shumë të drejtave të tjera. Secila nga këto situata do të kërkonte një modalitet tjetër të zgjidhjes. Ata kanë të njëjtë atë që duket se mungon - kur është fjala për intuitë - një mekanizëm për të mbështetur qytetarët që nuk ia dalin ose nuk janë në gjendje të sigurojnë ekstrakte nga të dhënat. Përveç në kontekst të procesit të negociatave dhe marrëveshjeve përkatëse teknike, zbatimi i të cilave është problematik, në faqet zyrtare të internetit, për shembull as të Mbrojtësi i qytetarëve i Republikës së Serbisë, e as të Ministria së Administratës Publike dhe Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Serbisë nuk është e mundur të gjenden më shumë informata të detajuara për vetë problemin e as nuk ka informata për iniciativat për bashkëpunim në këtë drejtim me institucionet e Kosovës.

Zgjidhja e statusit të shtetasve "të padukshëm ligjrisht" të kombësisë rome, veçanërisht atyre që si refugjatë dhe persona të zhvendosur kanë jetuar në vendbanimet joformale që nga viti 1999 dhe në të cilën punon Mbrojtësi i qytetarëve të Republikës së Serbisë dhe partnerët e tij për vite me radhë, ka përmirësuar pozicionin e tyre kështu që ata tani mund të ushtrojnë të drejtën për dokumente personale, regjistrimin e banimit, për të regjistruar fëmijët në librat amzë të lindjes dhe për të realizuar të drejtën për kujdes shëndetësor"<sup>64</sup>. (Prezantimi zyrtar i Mbrojtësit të qytetarëve, 12 shtator 2016)

Për shkak të skadimit të vlefshmërisë së dokumenteve dhe për shkak të të dhënave të shkatërruara apo të zhdukura në ndonjë mënyrë tjetër, si dhe pamundësisë për të marrë certifikatën, qytetarët mund të gjenden në situata të ngjashme si personat pa shtetësi. Në këtë kuptim, rëndësi vitale do të kishin rezultatet e rëndësishme, përvoja dhe praktika e mira e fituar nga sektori civil, organizatat ndërkombëtare dhe Mbrojtësi i qytetarëve të Republikës së Serbisë në gjetjen e zgjidhjes për problemin e pa shtetësisë dhe personave ligjrisht të padukshëm. Megjithatë, siç u përmend më lartë, politika për ndërtimin e kapaciteteve dhe shtrirjen e diapazonit të aktiviteteve të Mbrojtësit të qytetarëve në kontekstin që kemi të bëjmë këtu asnjëherë nuk është marrë parasysh.

---

refuzon të sigurojë librat për shërbimet kompetente (ose kopjet e tyre) me të dhëna për qytetarët nga pjesa veriore e Mitrovicës, prandaj ata pengohen të marrin dokumentet e tyre personale në zyrën përkatëse të gjendjes civile në pjesën veriore të Mitrovicës. (Qytetarët nga pjesa veriore e Mitrovicës janë drejtuar në pjesën jugore të Mitrovicës për lëshimin e certifikatës së lindjes). Në këtë drejtim, është e nevojshme që BE të gjejë zgjidhjen e duhur në periudhën e ardhshme dhe t'u mundësojë qytetarëve nga pjesa veriore e Mitrovicës të ushtrojnë të drejtat e tyre para zyrave kompetente të gjendjes civile "(Raporti i tetorit 2017), ndërsa për Republikën e Serbisë thuhet se "ka përmbushur plotësisht detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja për Librat" (Raportet nga prilli 2016, tetori 2015 dhe prilli 2015); shih në <http://www.kim.gov.rs/lat/izvestaji.php>

<sup>64</sup><http://www.ombudsman.rs/index.php/2011-12-25-10-17-15/2011-12-26-10-05-05/4879-b-ni-i-s-pi-r-sh-v-nju-pr-bl-r-s-lj-nih-s-s-v-i-hi>

## Shtetësia e dyfishtë: Perspektiva ndërkombëtare

Shtetësia e dyfishtë ka simbolizuar, gjatë historisë moderne, një çështje të diskutueshme dhe me probleme për shumë shtete anembanë botës. Deri para pak dekadash, ideja e dhënies së shtetësisë të dyfishta ose të shumëfishta për shtetasit e vet shikohej si mundësi për të destabilizuar potencialisht rendin politik dhe për të minuar integritetin territorial të shtetit, duke shkaktuar kështu përkeqësimin e marrëdhënieve ndërshtetërore.

Ky trend i zakonshëm dhe i përbashkët u pasqyrua mirë në kuadër të Konventës së Strasburgut të vitit 1963 mbi "Zvogëlimin e rasteve të shtetësisë së shumëfishtë dhe detyrimeve ushtarake në rastin e shtetësisë të shumëfishta", qëllimi i proklamuar i së cilës ishte "të zvogëlohej sa më shumë që të ishte e mundur numri i rasteve të shtetësisë të shumëfishta, si ndërmjet shteteve anëtare". Më saktësisht, për të arritur këtë qëllim, neni i parë i kësaj Konvente shpalli: "Shtetasit e Palëve Kontraktuese që janë me moshë madhore dhe që fitojnë me vullnetin e tyre të lirë, me anë të natyralizimit, zgjedhjes ose rinovimit, shtetësinë e një Pale tjetër do të ndikonte në humbjen e shtetësisë së mëparshme. Atyre nuk do t'iu lejohet të mbajnë shtetësinë e tyre të mëparshme".

Për më tepër, rritja e stabilitetit të politikës globale, ulja e konflikteve në shkallë të gjerë, përhapja e të drejtave individuale në konventat ndërkombëtare dhe fenomenet socio-ekonomike të lidhura me globalizimin, si migrime masive dhe ndërveprime më të shpeshta ekonomike midis shteteve, kanë formësuar qasje të ndryshme ndaj shtetësisë së dyfishtë. Këta faktorë të rëndësishëm kanë ndikuar në një pranim më të gjerë të shtetësisë së dyfishtë në shtetet të cilat hezitonin ta miratonin këtë praktikë dhe shumë prej tyre e kanë braktisur praktikën e detyrimit të emigrantëve për të hequr dorë nga "shtetësia e parë" e tyre. Ky ndryshim i rëndësishëm, në pajtim me punën e Departamentit për Politika të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Brendshme të Bashkimit Evropian, ka pasur pasoja të rëndësishme në shtetet me komunitete të mëdha emigruese: në fakt, pranimi i shtetësisë së dyfishtë është një mjet për të njohur të drejtën e një migranti për të marrë pjesë në jetën politike në vendin e tyre të origjinës, si dhe në atë të shtetëve të tyre të adoptuara. Për më tepër, një pranim i gjerë i shtetësisë së dyfishtë mund të ketë implikime thelbësore në Evropën Qendrore-Lindore, ku njohja e shtetësisë për popullatën e diasporës dhe pakicave etnike ende paraqet një çështje problematike.

Ky ndryshim i qasjes në lidhje me legjislacionin për shtetësinë u pranua mjaft dobët nga Konventa e Strasburgut e vitit 1997 ose Konventa Evropiane për Shtetësinë, e cila, në kundërshtim me konventën paraprake të vitit 1963, shpalli neutralitetin e saj substancial në çështjen e shtetësisë së dyfishtë. Për të konfirmuar këtë, është e mundur të përmendim një pjesë të preambulës së Konventës, në të cilën thuhet se "duke vene re qëndrimet e ndryshme të shteteve për çështjen e shtetësisë së shumëfishtë, dhe duke njohur që çdo shtet është i lire të vendose se çfarë pasojash i bashkëngjijt ne të drejtën e tij të brendshme faktit që një shtetas fiton ose posedon një tjetër shtetësi". Për më tepër, qëllimi i "Konventës Evropiane për Shtetësinë" është të nxisë shtetet anëtare të parandalojnë çdo lloj diskriminimi ndaj qytetarëve të vet që vendosin të aplikojnë për një shtetësi tjetër, ose ndaj të huajve që aplikojnë për shtetësinë e vendit pritës". Sidoqoftë, siç thuhet në nenin tre, është e rëndësishme të theksohet se kjo

Konventë nuk ka norma të detyrueshme, por lejon çdo shtet anëtar të vendosë, në mënyrë të pavarur, nëse dhe si të hartojë legjislacionin për shtetësinë.

E njëjta qasje reflektohet edhe në nivel ndërkombëtar, ku ekziston një mungesë e konventës në lidhje me çështjen e shtetësisë së dyfishtë. Kjo i lihet marrëveshjeve bilaterale midis shteteve dhe prerogativat individual të shteteve sovrane: Përkundër gatishmërisë së shtuar për njohjen e shtetësisë së dyfishtë, ende ekzistojnë 62 shtete që nuk njohin të drejtën për të marrë më shumë se një shtetësi.

Kjo mungesë e juridiksionit dhe konventës bën të mundur që edhe në ditët e sotme të ketë tensione dhe mosmarrëveshje mes shteteve në këto tema, si në rastin e Sllovakisë dhe Hungarisë, Austrisë dhe Italisë, Rosisë dhe Shteteve Baltike, Qipros Veriore dhe Qipros Greke.

Lidhur me shembullin e fundit, situata ishte mjaft kritike sa për të tërhequr vëmendjen e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila mbuloi këto ngjarje problematike në "Raportin e Zyrës së Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në Qipro" në vitin 2011 . Ky raport denoncoi shkeljen e vazhdueshme të së drejtës së lirisë së lëvizjes për qytetarët grekë të Qipros, të cilët janë të ekspozuar ndaj shumë kufizimeve. Për më tepër, nga ana tjetër, qytetarët e Qipros turke po planifikojnë të padisin Republikën e Qipros në bazë të diskriminimit për refuzimin e pretenduar të tyre për t'u dhënë atyre shtetësi; siç raportohet nga "Cyprus Mail", rasti ka të bëjë me aplikuesit, një prind turk të Qipros dhe një nga Turqia ose një shtet tjetër, të cilëve i është refuzuar shtetësia nga Republika e Qipros. Ky refuzim ka një ndikim jashtëzakonisht negativ në jetën e këtyre aplikuesve, të cilët përballen me pengesa të pakapërcyeshme për gjithë aspektin e jetës së tyre, si njohja e një martese të përzier me qytetarët e Qipros greke apo mundësia për të gjetur një punë të rregullt në Republikën e Qipros. Për të konfirmuar këtë, duhet të përmendim 17 000 fëmijë nga martesat e përziera midis turqve të Qipros dhe popullatës së Turqisë, të cilëve u mohohet shtetësia e Qipros. Për më tej, për turqit e Qipros, shtetësia e Qipros përfaqëson një mënyrë thelbësore për t'u larguar nga vendi, pasi që pasaporta e turqve të Qipros njihet vetëm në gjashtë vende.

## V. Konkluzionet:

Kjo, në esencë, është çështje e sundimit të ligjit dhe të qeverisjes së mirë. Katreguar një shkallë të caktuar madje ndoshta edhe të përhapur të mosfunksionimit në aspektin e zbatimit të legjislacionit përkatës të organeve dhe strukturave qeverisëse dhe administrative. Në këtë frymë, qasja në shtetësi mund të karakterizohet si një çështje kryesisht politike dhe jo juridike, e cila lidhet drejtpërdrejt me një shkallë të lartë të dykuptimësisë në praktikat institucionale dhe në një numër çështjesh ende të pazgjidhura midis Kosovës dhe Serbisë. Pasi u tha kjo, refuzimi i qeverisë së Kosovës për të njohur vlefshmërinë e dokumenteve të lëshuara nga institucionet e Republikës së Serbisë, ka dëshmuar të jetë një pengesë e rëndësishme për serbët e Kosovës në marrjen e shtetësisë së Kosovës. Për më tepër, fakti se qeveria e Kosovës nuk pranon si dëshmi të lindjes dhe/ose qëndrimit të vazhdueshëm në Kosovë çfarëdo dokumenti të lëshuar nga institucionet e Serbisë në Kosovë (si spitalet, shkollat, regjistrat civilë) do të thotë që shumë banorë të lindur gjatë ose pas viteve 1990 gjenden në një situatë në

të cilën ata kanë të drejtë marrin shtetësinë e Kosovës, por ende nuk janë në gjendje. Fakti që ata, në parim dhe në praktikë, shihen si ilegalisht të pranishëm në territorin e lindjes së tyre, është jashtëzakonisht problematik, si në kontekst ligjor, ashtu edhe politik. Politikat arbitrare dhe ligjrisht të paqarta të qeverisë së Kosovës në thelb paraqesin rastin e një komuniteti shumicë që nuk po ia del të prodhojë një sërë politikash koherente ndaj pjesëve jo-shumicë të popullsisë që ka rezultuar në krijimin e një vrime të zezë ligjore dhe politike. Është e qartë se shumë anëtarë të komunitetit shumicë të Kosovës e shohin këtë si një çështje që lidhet në mënyrë të pashmangshme me çështjet e sovranitetit territorial, megjithatë, ky qëndrim ka pasur një efekt pa dyshim të padëshirueshëm në strukturat dhe organet institucionale në kurriz të të drejtave të shumë pjesëtarëve të komunitetit jo-shumicë.

*Liberalizimi i Vizave i Bashkimit Evropian për Kosovën: Udhërrëfyesi* adresoi këto çështje në një mënyrë relativisht të qartë. Parashihet që qeveria e Kosovës të përmbush kriteret që përfshijnë miratimin dhe zbatimin e masave që "rrisin integritetin efektiv të personave që u përkasin pakicës serbe, rome, ashkalinje, egjiptiane, boshnjake, turke dhe gorane"<sup>65</sup>. Për më tepër, theksohet se qeveria duhet të "sigurojë që të gjithë qytetarët e Kosovës, përfshi gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat që u përkasin minoriteteve dhe individëve të tjerë të cenueshëm, të kenë qasje të plotë dhe efektive në dokumentet e udhëtimit dhe identitetit personal, përfshirë regjistrimin civil"<sup>66</sup>. Duket se qeveria aktualisht është duke i shkelur këto dispozita dhe ka nevojë të rrisë thellësinë dhe shpejtësinë e politikave të tyre, të orientuara drejt lehtësimit të qasjes në shtetësi.

Çështja e diskriminimit të mundshëm është natyrisht thumbuese dhe është vështirë të provohet nga pikëpamja ligjore. Pasi u tha kjo, nëse vështirësitë me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë në qasjen në shtetësi janë për shkak të faktorëve të motivuar etnikisht ose thjesht mund të zëbërthehen në nivel të një formë të paafësisë administrative, ndoshta nuk ka rëndësi në dritën e faktit se rezultati është në thelb i njëjtë: banorët nuk janë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre themelore qytetare.

Prandaj është në interes të të gjitha palëve dhe akterëve relevant politikë dhe social të gjejnë një zgjidhje apo një sërë zgjidhjesh që do të hapin rrugën për rregullimin e statusit ligjor të serbëve të Kosovës në Kosovë, në mënyrë që të shmanget situata në të cilën të drejtat e tyre themelore njerëzore dhe civile janë të rrezikuara edhe më shumë. Fakti që ata persona që nuk kanë ndonjë dokumentacion që qeveria e Kosovës e konsideron të ligjshëm dhe legjitim, i vendos ata në një situatë delikate dhe ndoshta edhe të rrezikshme që i bën ata të pambrojtur ndaj abuzimit. Prandaj është e domosdoshme që qeveria e Kosovës, si dhe komuniteti ndërkombëtar, të ndërmarrin hapa konkret për të siguruar se serbët në Kosovë janë në një pozitë për të ushtruar plotësisht të drejtat e tyre si qytetarë të Kosovës, si dhe qytetarë të Serbisë.

---

<sup>65</sup><https://www.esiweb.org/pdf/White%20List%20Project%20Paper%20-%20Roadmap%20Kosovo.pdf>

<sup>66</sup>IBID.

## **VI. Rekomandimet:**

**1. Qeveria e Kosovës duhet të nxjerrë një sërë udhëzimesh të reja administrative që do t'u lejojnë institucioneve dhe autoriteteve përkatëse të pranojnë dokumente të lëshuara nga të ashtuquajturat institucione paralele serbe dhe Drejtorinë Koordinuese e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë si dëshmi relevante gjatë pranimit të kërkesave për shtetësi.**

Kjo do të dëshmohet si çelës në zbutjen dhe lehtësimin e procesit të marrjes së shtetësisë për serbët e lindur gjatë dhe pas viteve 1990, si dhe për personat e zhvendosur brenda vendit dhe refugjatët. Duke marrë parasysh faktin se këto dokumente u janë lëshuar individëve brenda kuadrit ligjor, institucional dhe kushtetues të Serbisë, ato dëshmojnë legjitimitetin e kërkesave për lindje dhe/ose qëndrim të vazhdueshëm në territorin e Kosovës. Kjo duhet të shoqërohet me një fushatë informuese gjithëpërfshirëse dhe transparente të orientuar drejtë komuniteteve të prekura jo-shumicë, që do të shërbente për të qartësuar të drejtat e tyre themelore gjatë përpjekjes për të marrë shtetësinë e Kosovës.

**2. Qeveria e Kosovës duhet të nxjerrë një urdhër administrativ që legjitimon dokumentet e identitetit (pasaportat) e lëshuara nga Drejtoria Koordinuese e Ministrisë së Punëve të Brendshme Serbe në mënyrë që të shmangët kufizimi i lirisë së lëvizjes së atyre që posedojnë këto dokumente**

Kjo do të sigurojë lirinë e lëvizjes së një numri të madh serbësh në Kosovë, duke siguruar në të njëjtën kohë statusin e tyre si shtetas të dyfishtë sipas ligjit të Kosovës. Për më tepër, qeveria duhet të bëjë të qasshme për publikun të gjitha vendimet ligjore dhe administrative që lidhen me këtë çështje dhe të sigurojë qartësi në komunitetet lokale lidhur me atë se cilat dokumente mund të përdorin për të kaluar kufirin me qëllim lehtësimin e lirisë së lëvizjes.

**3. Përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare dhe organizatave lokale jo-qeveritare serbe në përpjekjet lobuese për të siguruar lehtësinë e qasjes në shtetësi për serbët e Kosovës**

Deri më tani, çështja e shtetësisë ishte në tërësi nën radarin e misionëve dhe organizatave ndërkombëtare dhe nuk ka qenë prioritet në kushtet e negociatave në vazhdim midis Beogradit dhe Prishtinës. Për të arritur një zgjidhje të zbatueshme dhe të pranueshme, nevojitet përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare si dhe e sektorit të shoqërisë civile. Me këtë në mendje, rekomandohet që bashkësia ndërkombëtare, përkatësisht ata akterë që ushtrojnë ndikim të rëndësishëm mbi çështjet e brendshme të Kosovës, si Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, të marrin një qasje më proaktive në përcjellje nëse qeveria e Kosovës po ndërmer hapa për të zbutur problemet e lidhura me fitimin e shtetësisë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë forcimin e kapaciteteve dhe rolit të organizatave të shoqërisë civile si akterë të politikave dhe si një organ konsultimi i domosdoshëm në aspektin e zhvillimit dhe zbatimit të politikave. Një raport i nxjerrë nga Parlamenti Evropian në vitin 2016 thotë se: "EUPARL shpreh keqardhje lidhur me faktin se shoqëria civile nuk konsultohet rregullisht si pjesë e procesit të vendimmarrjes; nxit nevojën për të fuqizuar më tej shoqërinë civile dhe kërkon që vullneti politik të tregohet i angazhuar me shoqërinë



civile duke zbatuar standardet minimale për konsultim publik”<sup>67</sup>. Kjo mund të përfshijë një rialokim fondesh për organizatat lokale të shoqërisë civile që avokojnë për interesat e komuniteteve të ndryshme jo-shumicë si dhe ndërmarrjen e hapave konkret për të lehtësuar përfshirjen e tyre në zhvillimin e politikave të reja dhe efektive në lidhje me qasjen në shtetësi. Kjo mund dhe duhet të përfshijë:

- Bashkësinë ndërkombëtare e cila fuqizon bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në komunitetet jo-shumicë në formën e krijimit të një grupi punues të dedikuar për adresimin e çështjeve që lidhen me qasjen në shtetësi që do të shërbente gjithashtu edhe si organ raportues;
- Organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në komunitetet jo-shumicë duhet të jenë në gjendje të raportojnë dhe të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me bashkësinë ndërkombëtare, si dhe qeveritë e Serbisë dhe të Kosovës;
- Organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në komunitetet jo-shumicë rritin kapacitetin dhe përpjekjet e tyre për të dokumentuar dhe monitoruar çështjet që lidhen me shtetësinë dhe marrjen e dokumenteve dhe akterët relevant të cilët ndërmarrin hapa konkret për t'i korrigjuar ato;
- Një përpjekje e bashkërenduar përmes fushatave publike për të rritur ndërgjegjësimin për këto çështje dhe për organizatat joqeveritare që potencialisht mund të ofrojnë ndihmë
- Konferenca dhe ngjarje rrjetëzimi për organizatat joqeveritare në Kosovë dhe në Serbi që merren me këto dhe çështje të ngjashme.

#### ***4. Rritja e transparencës në lidhje me disponueshmërinë e informatave për popullatën e përgjithshme si dhe sqarime në lidhje me bazën ligjore të çfarëdo urdhri dhe/ose politikë në lidhje me qasjen në shtetësi***

Qeveria e Kosovës, së bashku me Avokatin e Popullit të Kosovës, duhet të ndërmarrë një përpjekje për të informuar qytetarët për çështjet që lidhen me marrjen e shtetësisë në formë të një fushate gjithëpërfshirëse informuese që do t'u siguroj palëve të interesuara mjetet dhe njohuritë e nevojshme për të lehtësuar qasjen e tyre në shtetësi. Kjo duhet të përfshijë, por jo të kufizohet në:

- Fuqizimin e cilësisë së informacionit të informatave konkrete të ofruara në faqet e internetit të agjencive përkatëse qeveritare
- Sigurimi se komunitetet janë të vetëdijshme për të drejtat e tyre, si dhe mekanizmat për t'i mbrojtur ata
- Krijimi i një portali informativ të dedikuar çështjeve të qasjes në shtetësi

#### ***5. Përfaqësuesit politikë të komunitetit serb në Kosovë si dhe ata që përfaqësojnë Qeverinë e Republikës së Serbisë në procesin e negociatave e marrin këtë çështje si çështje prioritare gjatë procesit të negociatave***

---

<sup>67</sup><http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=TA&reference=P8-TA-2017-0262&language=EN&ring=A8-2017-0062>

Edhe pse është adresuar, të paktën në mënyrë joformale, kjo çështje duhet të bëhet një çështje prioritare nga përfaqësuesit politikë të komunitetit serb në Kosovë dhe të gjithë akterët relevantë duhet të insistojnë në zgjidhjen e saj të shpejtë dhe efektive në mënyrën që plotësisht respekton dhe merr në konsideratë të drejtat themelore të njeriut dhe civile të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë.

## **6. Ndërlidhja ndërmjet ombudsmanëve në Kosovë dhe Serbi - si organe të drejtave të njeriut, si dhe institucione që sigurojnë qeverisje të mirë**

Krijimi i kanaleve konkrete të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet ombudsmanëve është një element kyç për të siguruar që komunitetet lokale të jenë në gjendje të kenë qasje të lehtë në shtetësi në mënyrën që është në përputhje me të drejtën dhe konventat vendore dhe ndërkombëtare. Ky bashkëpunim dhe ndërlidhje mund të lehtësohen nga akterët e shoqërisë civile dhe të sigurojë një mjet për të ofruar këshilla të njëkohshme për banorët lokal sa i përket sistemit ligjor të Kosovës dhe të Serbisë. Rezoluta e Parlamentit Evropian e vitit 2017 për raportin e Komisionit të BE në 2016 vuri në dukje se<sup>68</sup>:

Duke përgëzuar krijimin e Grupit Koordinues Ndërmistror për të Drejtat e Njeriut në vitin 2016, vërehet se nevojiten përpjekje të mëtejshme për të mbrojtur të drejtat e të gjitha pakicave në Kosovë, duke përfshirë komunitetin rom, ashkali, egjiptian dhe goran, nëpërmjet zbatimit të plotë të legjislacionin dhe ndarjen e burimeve të mjaftueshme; u bën thirrje autoriteteve kompetente qendrore dhe lokale për të ndërmarrë, si çështje prioritare, të gjitha masat e nevojshme legislative dhe praktike për të kufizuar diskriminimin dhe për të afirmuar të drejtat e pakicave të ndryshme etnike, duke përfshirë të drejtat kulturore, gjuhësore dhe pronësore, në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin e një shoqërie shumetnike; i bën thirrje Kosovës që të sigurojë që refugjatët e kthyer, shumica prej të cilëve janë romë, të jenë plotësisht të integruar dhe të rivendosen të drejtat e tyre si shtetas, duke i dhënë fund pa shtetësisë; i bën thirrje Kosovës që të miratojë një strategji të re dhe një plan veprimi për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;

Kjo krijon një hapësirë dhe nismë shumë të qartë për institucionet qeveritare dhe shtetërore për të zgjeruar dhe thelluar përpjekjet e tyre për të lehtësuar integrimin ligjor të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në mënyrë jo diskriminuese. Ndërmarrja e hapave konkretë për të krijuar kanale institucionale të bashkëpunimit të përhershëm dhe koordinimit në mes të ombudsmanit të Serbisë dhe të Kosovës paraqitet si një mundësi e rëndësishme për të krijuar sinergji të reja në fushën e të drejtave të njeriut dhe civile. Një përpjekje e përbashkët për të lehtësuar dhe zbutur qasjen në shtetësi dhe dokumente të tjera bazike të identitetit do të çonte në mbrojtje më të madhe të lirive themelore, siç janë liria e lëvizjes dhe sigurimi që banorët kanë dhe janë në dijeni të mekanizmave në dispozicion të tyre në rast të shkeljeve të mundshme të të drejtave.

---

<sup>68</sup><http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?type=TA&reference=P8-TA-2017-0262&language=EN&ring=A8-2017-0062>

## **7. Programe trajnimi për ekspertët ligjorë dhe për punonjësit e qeverisë**

Sigurimi i programeve të trajnimit, të orientuara posaçërisht tek punonjësit shtetëror që trajtojnë kërkesat për shtetësi, si dhe ekspertë ligjorë që ofrojnë ndihmë ligjore falas me të cilën do të synohej rritja e kuptimit nga këta persona për çështjet e shtetësisë si dhe të drejtat themelore të aplikuesve.

## **8. Rritja e përfshirjes së komunitetit ndërkombëtar dhe sqarim i pozitës së akterëve të ndryshëm ndërkombëtarë**

Akterët dhe misionet ndërkombëtare të pranishme në Kosovë duhet dhe do të luajnë rol vital në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Hapi i parë i rëndësishëm është sqarimi i pozitës së bashkësisë ndërkombëtare rrethçështjes së shtetësisë si dhe intensifikimi i përpjekjeve lobuese për të ushtruar presion pozitiv ndaj shtetit të Kosovës për të ndërmarrë hapa të prekshëm, efektiv dhe të arsyeshëm për të krijuar një rrugë të zbatueshme për shtetësi për ata, të cilëve i është mohuar.


Si pjesë e kësaj, Bashkimi Evropian gjithashtu duhet të qartësojë dhe të shpjegojë pozicionet e veta në lidhje me përfshirjen e pasaportave të lëshuara nga "Qeveria e Përkohshme e Serbisë në Kosovë" në listën e vet të të ashtuquajturave "pasaportave imagjinare". Duhet të bëhet e qartë se kjo *nuk e* vë në pikëpyetje pranueshmërinë e dokumenteve zyrtare të udhëtimit të lëshuara nga Qeveria e Republikës së Serbisë.

## **9. Fushata informuese nga ana e qeverisë së Republikës së Serbisë**

Siç u propozua më parë për qeverinë e Kosovës, shteti i Serbisë gjithashtu duhet të kërkojë të përmirësojë qasjen në informata nëpërmjet rritjes së cilësisë dhe gjerësisë së informacionit në disponim të menjëhershëm për ata që kërkojnë të zgjidhin problemet që lidhen me dokumentacionin personal.

## Outline

- I. Introduction
- II. Problem description: a Kafkaesque situation for Serbian citizens?**
- III. Legal analysis: Kosovo system
- IV. Legal Analysis: Serbian system
- V. Case studies: Serbs in Kosovo without access to Kosovo nationality
- VI. Conclusion(s)
- VII. Recommendations



# I. Introduction

The history of citizenship and nationality has been a storied one that has over time evolved slowly to become what is now widely seen as an inalienable right, the denial of which is tantamount to a negation of personhood. Citizenship has furthermore come to be associated with something that is fundamental not only to personal identity<sup>1</sup> but also indispensable in the ability of an individual to exercise basic functions within the framework of the modern state. *The Universal Declaration of Human Rights* was one of the first, if not the first, internationally recognized and ratified document that posited citizenship as a basic human right<sup>2</sup> and that arbitrary deprivation of nationality is a violation of that human right. This was followed by the adoption of an extensive framework of international and regional conventions that regulate citizenship, dual citizenship and statelessness. Despite this, in 2018, problems of statehood, citizenship and indeed statelessness continue to blight many regions of the world. An intricate web of legal frameworks that regulate the right (or perhaps, in some cases, the lack thereof) to nationality and/or citizenship has in many cases failed to prevent large populations of people, often in the aftermath of conflict, from losing access to statehood and all of the benefits that it entails.

Although (access to) citizenship is broadly seen as a basic human right, it is also true that the idea of state sovereignty dictates that individual countries have the right to regulate, through their individual legal and constitutional foundations, the acquisition of citizenship and the specific demands and burdens placed on individuals for obtaining citizenship. Likewise, there is no requirement in international or European law that requires states to allow for dual citizenship.<sup>3</sup> Indeed, many states either do not permit it at all or they have limited or restricted versions of it<sup>4</sup>. Therefore, when it comes to these issues individual states have wide prerogative in determining individual eligibility for citizenship.

Citizenship, as a concept that is intrinsically and inherently connected to a sense of both personal and collective belonging, is a particularly complex and opaque issue in the former Yugoslavia. Furthermore, it is an area in which emotional rather than practical considerations can sometimes take precedence as the acquisition of citizenship of enemy or formerly enemy states is an act that can be fraught with both figurative and literal peril. This is perhaps especially true in Kosovo, whose large Serbian community (particularly in the north) has, at times, resisted attempts at integration into the legal and institutional framework of Kosovo. It is, in Kosovo's case, not merely a legal issue but also a political question that at its heart provokes strong reactions from both sides of the ethnic divide.

---

<sup>1</sup>White, Philip L. (2006). "Globalization and the Mythology of the Nation State," in A. G. Hopkins (ed.), *Global History: Interactions Between the Universal and the Local* (Palgrave Macmillan).

<sup>2</sup>Universal Declaration of Human Rights, Article(s) 15.1 and 15.2.

<sup>3</sup>Donner, R.: *Dual Nationality in International Law*, *Acta Juridica Hungarica*, 47, No 1, pp. 15-25., Budapest, 2006.

<sup>4</sup>Donner, R.: *Dual Nationality in International Law*, *Acta Juridica Hungarica*, 47, No 1, pp. 15-25., Budapest, 2006.



This policy paper will attempt to tackle the complicated issue of access to citizenship in Kosovo. As previously mentioned, it must be highlighted here that there is significant intersection between political and legal issues and that in many cases it is difficult or impossible to segregate the two. Taking this into consideration, the paper will take into account both legal and political factors that have led to the current impasse. Furthermore, the existence of a legal framework that is widely considered to be fully in line with European conventions and law has not necessarily meant that access to citizenship is not hampered by procedural errors and even by blatantly discriminatory practices on the part of state employees. Furthermore, the situation has been further convoluted by the fact that the Kosovo government considers documents issued by the Serbian Ministry of Interior Coordination Directorate for Kosovo to be invalid. This puts Kosovo Serbs who lack Kosovo identification cards and passports in a legal and administrative grey area due to the fact that the Kosovo government considers those Serbs born in Kosovo to be citizens, regardless of whether or not they have applied for citizenship documents.<sup>5</sup>

Therefore, this paper will examine the legal and political status of those Kosovo Serbs who have been, thus far, either unable or unwilling to obtain Kosovo citizenship and the implications for their future legal position. This question will be explored through a variety of perspectives and will take into consideration the overall political context, as well as analyses of both the Kosovo, Serbian and international legal frameworks.

